



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

---

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE  
TË LËNDËS “HISTORI”**

**2017**

**1. HYRJE**

Aftësia e mësuesve për ta bërë arsimimin e nxënësve, “preokupimin” kryesor të ditës, kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtjesore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së historisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së Historisë në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit si dhe të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Ky program është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- Dokumente zyrtare<sup>1</sup>, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësimdhënie - nxënies;
- Programe përkatëse lëndore;
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënie;
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- Përmbajtjen shkencore e lëndës, sipas programeve përkatëse të historisë.

---

<sup>1</sup> Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

## **2. QËLLIMI I PROGRAMIT**

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së Historisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DAR/ZA-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

### ***Programi synon që mësuesi:***

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat profesionale të kuadrit mësimitdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimitdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e metodave për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve, kompetencave dhe ligjësive të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimitdhënie-nxënies.
- të përdorë aftësitë e TIK-ut, si një nga risitë më të fundit në mësimitdhënien bashkëkohore.

## **3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

<b>FUSHA : DOKUMENTE ZYRTARE</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor</b></p> <p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr. 343, datë 19.08.2013.</li> <li>• Udhëzimi nr. 16, datë 03.08.2016 për vitin shkollor 2016-2017, në sistemin arsimor parauniversitar.</li> <li>• Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 26, datë 15.08.2015 “Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë”.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, nr. 2, datë 12.02.2015.</li> <li>• Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Karta e performancës së shkollës.</li> <li>• Standardet e shkollës si qendër komunitare.</li> </ul>
--	--

<b>FUSHA: PROGRAME LËNDORE</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të historisë në shkollë</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;</li> <li>• përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;</li> <li>• përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kurrikula bërthamë AMU, klasat 6-9, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AML, klasat 10-12, 2016.</li> <li>• Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat 6 – 7 dhe klasa 10.</li> </ul>

<p>pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• harton objektiva për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat e programit;</li> <li>• kategorizon objektivat e programit sipas shkallëve të taksonomisë së Blumit;</li> <li>• harton objektiva specifike që u përgjigjen niveleve të ndryshme të nxënësve;</li> <li>• tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të historisë);</li> <li>• shpjegon lidhjen program-tekst nxënësi;</li> <li>• përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;</li> <li>• siguron informacion që demonstroi lidhjen e historisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	
--	--

<b>FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE</b>	
<b>Kompetenca I</b> <b>Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e historisë</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>• përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>• demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>• identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</li> <li>• demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së historisë;</li> <li>• edukon të nxënësit një dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës së historisë;</li> <li>• motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>• të krijojë klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>• punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	
<b>Kompetenca II</b> <b>Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e historisë</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>• planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>• përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> <li>• përdorë proceset historike në mësimdhënien – nxënien e historisë;</li> <li>• demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</li> <li>• shpjegon parimet e hartimit të një testi;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënësin, metodologjinë e mësimdhënies së historisë.</li> <li>• Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca në gjimnaz, 2016</li> </ul>
<b>Kompetenca III</b> <b>Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>

<b>komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në histori</b>	
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezanton ngjarje/çështje historike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Word;</li> <li>• nxit nxënësit të bëjnë kërkime dhe prezantime duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;</li> <li>• gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>• përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së historisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekstet e informatikës që përdorin nxënësit.</li> <li>• Literaturë që ka në fokus përdorimin e programeve kompjuterike.</li> </ul>

<b>FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT</b>	
<b>Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>• sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>• Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.</li> </ul>

<b>FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE</b>	
<b>Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>

<b>shqipe</b>	
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe;</li> <li>• demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

<b>FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së Historisë</b>	
<p><i>Mësuesi i historisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e historisë në klasat 1-9 dhe klasat 10-12;</li> <li>• përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve historike në klasat 1-9 dhe klasat 10-12;</li> <li>• përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve;</li> <li>• dallon ndërvarësinë e koncepteve historike nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;</li> <li>• shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që i përkasin periudhave të ndryshme historike për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre;</li> <li>• shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike;</li> <li>• komunikon njohuritë historike në forma të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;</li> <li>• ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat dhe ngjarjet e rëndësishme historike;</li> <li>• shpjegon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse jo, për kë për ngjarje/çështje të ndryshme historike;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste të lëndës për mësuesin dhe nxënësin, materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.</li> </ul>



- shpjegon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve historike për periudha të ndryshme të historisë;
- dallon se si njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike.
- vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme;
- interpreton të efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes
- vlerëson pozitën e qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- shpjegon vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli
- demonstroi aftësi të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë.
- shpjegon se lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsi, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.